



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1550/16 Prot.

Tiranë, më 13.06.2023

V E N D I M

Nr. 66 datë 13.06 2023

**“MIRATIMIN E SHITESËS NË BUXHETIN E VITIT 2023 TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, ME BURIM FINANCIMI
TË ARDHURAT E VETA”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, pika 1/h të nenit 38 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së pika o të nenit 20, në Vendimin nr.55 datë 26.05.2023 të Senatit Akademik, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 39 datë 29.05.2023 “Miratimin e pagave të stafit akademik të Universitetit të Uporteve të Tiranës, sipas VKM nr. 243 datë 20.04.2023 “për disa ndryshime në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të këshillit të ministrave” për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, në Vendimin e Rektoratit nr. 56 datë 08.06.2023 “Miratimin e shtesës në buxhetin e vitit 2023 të Universitetit të Sporteve të Tiranës me burim financimi të ardhurat e veta”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 13.06.2023

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesë në buxhetin e vitit 2023 të Universitetit të Sporteve të Tiranës me burim financimi nga të ardhurat e veta, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Ky Vendim i dërgohet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr.Agron KASA

